

STATUTI

**STATUT I SHOQËRISË
“MATERIA CONS 01” SHPK**

Ne Tirane, sot me date 08/11/2019 unë Z. **Qemal DEDJA**, i biri i Allamanit, i datelindjes 29.06.1969, ne Derjan, Mat, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. 032057000 dhe nr. Personal G90629051O personal, me date leshimi 23.01.2013, ne cilesine e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lire të plete e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, hartoj statutin e shoqerise **“MATERIA CONS 01” SHPK**.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria **“MATERIA CONS 01” SHPK** është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne Organet Kompetente, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“MATERIA CONS 01” SHPK**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Z. **Qemal DEDJA**, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Struktuore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 1





STATUTI

Shoqëria e ka selinë ne adresën Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

Neni 4- Objekti i veprimitarise

Objekti i veprimitarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Ndertim objektesh, ura, prita, ujesjellesa, kanalizime, punime mbrojtje etj. Ndertime civile dhe ekonomike. Rikonstruksion godinash civile, ekonomike dhe veshje fasadash. Prodhim guresh dekorativ dhe inerte. Pastrim dhe gjelberim i hapesirave publike. Rehabilitim i objekteve pas shfrytezimit. Instalime elektrike dhe hidraulike. Ndertim dhe mirembajtje rruge dhe kanalizime. Materiale ndertimi, punime ndertimi, hoteleri, turizem. Ngritja dhe mbulimi i konstruksioneve te kulumve. Punime dhe sherbime te tjera te specializuara ne ndertim. Suvatime dhe montime dyer, dritare, shkalle etj. si dhe kryerja e aktiviteteve te tjera te ngjashme me to. Punime dhei, sistemim tarracash te terreneve. Prodhim i elementeve te paranderur dhe armocementit. Tregti pajisjesh te ndryshme, materiale ndertimi dhe mallra te import-eksport me shumice dhe pakice. Ushtrimi i aktivitetit ne fushen e Studimit dhe Projektimit dhe/ose Mbikqyrjes dhe Kolaudimit ne fushen e ndertimit.

Neni 5- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat.

KREU II KAPITALI

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 (njëqind mijë)** lekë. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem" i shoqerise **Qemal DEDJA**, dhe perbet nga 1 (*nje*) pjese/kuote me vlerë te pergjithshme **100.000 (njëqind mijë)** leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 2



STATUTI

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7- Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Zvogelimi dhe zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkojen për ndryshimin e statutit.

Neni 8

Kuotat

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Bisnesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Transferimi i kuotave te te tretet kufizohet me miratim te asamblese se ortakut në të njëjtat kushte që kërkojen për ndryshimin e statutit.

KREU II

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 3



STATUTI

modalitetet e percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- c) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10 - Administrimi

Administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i shoqërisë **Z. Qemal DEDJA**, i biri i Allamanit, i datelindjes 29.06.1969, ne Derjan, Mat, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjofitimin me nr. 032057000 dhe nr. Personal G90629051O personal, me date leshimi 23.01.2013. Administratori mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 11 - Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 4



STATUTI

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat pér të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakut te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 5



STATUTI

Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:


- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;





STATUTI

- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni14 Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.
Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 Ekspertet

Eksperi ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithnjëtor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.
Ne perfundim të kontrollit eksperi kontabel i autorizuar percatat raportin me shkrim per nxjerjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.


Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve llojore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

Neni 17

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 7





STATUTI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përvçese kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtyj ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, përmbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme përmes pagesës së këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 8



STATUTI

pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpérndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut te Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërise ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

Sellia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Struktuore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 9

STATUTI

Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

- kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me reportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja përmarrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe përpali e treta
- bërjen e aksionarëve/ortakut të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërite pritëse, në përputhje me reportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shnderrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruehet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "MATERIA CONS 01" SHPK

Qemal DEDJA

OCM 21/2019

Selia: Tirane, Tirane, Nen-Njesine Strukturore 1-34, Rruga Anastas Kullorioti, per objektin 8 kate me 2 kate nentoke.

Faqe 10



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË**

Notere Elona A. SYLA

Nr. 2612 Rep

2

VËRTETIM

Ne Tirane, sot, me date 11/11/2019 (*Dymije e nentembëdhjetë*) para meje Noteres Elona A. Syla, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën "Rr. Shyqri Bërxolli", Pall. "Aurora", Kt.2, Tiranë, u paraqit personalisht:

1. **Z.Qemal DEDJA**, i biri i Allamanit, i datelindjes 29.06.1969, lindur ne ne Derjan, Mat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin nr. Personal G90629051O;

I cili në cilësinë e ortakut themelues te Shoqerise "Materia Cons 01" Shpk konfirmoi nënshkrin e tij ne Statutin e Shoqerise "Materia Cons 01" Shpk te dates 09.11.2019, me vullnetin e tij te lire e te pavesuar, dhe une noteri pasi u binda për identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve individuale qe mbante me vete i vërtetoj ato sipas kompetencave që parashikon ligji 110/2018 "Për noterinë". Unë noterja, në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (*i ndryshuar*), deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akt notarial/vertetim notarial në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

